

LIGJ
Nr.8287, datë 18.2.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8038, DATË 23.11.1995 “PËR
TELEKOMUNIKACIONET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8038, datë 23.11.1995, neni 2.1 ndryshohet si vijon:

“Shteti përcakton politikën e zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet ministrit përkatës, në vartësi të të cilit është Drejtoria e Përgjithshme e Postave dhe Telekomunikacioneve (DPPT) dhe rregullon sektorin e telekomunikacioneve nëpërmjet Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT). Statusi, detyra, të drejtat dhe struktura e ERT përcaktohen me ligj.”

Neni 2

Neni 2.2 ndryshohet si vijon:

“Detyrat kryesore të DPPT janë:

1. Të nxitë zhvillimin e industrisë kombëtare të telekomunikacioneve.
2. Të stimulojë zhvillimin dhe investimet në sektorin e postave dhe të telekomunikacioneve.
3. Të bashkërendojë planet e zhvillimit të rrjeteve të telekomunikacioneve për nevojat e institucioneve shtetërore, si të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme etj.
4. Të mbledhë e të përpunojë të dhëna statistikore nga gjithë operatorët publikë të postave dhe të telekomunikacioneve të vendit.
5. Të bashkërendojë shërbimet kombëtare të radiondërlidhjes bregdetare.
6. Të ndjekë zbatimin e detyrimeve për sektorin e postave dhe të telekomunikacioneve, që rrjedhin nga marrëveshjet, konventat a protokollet dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe, ku aderohet Republika e Shqipërisë.
7. Të mbështesë veprimtaritë e shoqatave të radioamatorizmit në Shqipëri.”

Neni 3

Neni 2.3 ndryshohet si vijon:

“Ministri:

1. I propozon Këshillit të Ministrave strategjinë e zhvillimit të sektorit të postave dhe telekomunikacioneve dhe/ose aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtaritë dhe shërbimet e postave dhe telekomunikacioneve.
2. Përfaqëson Qeverinë Shqiptare në marrëveshjet, konventat a protokollet dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe që nënshkruhen me qeveritë e vendeve të tjera për sektorët e postave dhe të telekomunikacioneve.”

Neni 4

Neni 3.1 ndryshohet si vijon:

“Shërbimet publike të telekomunikacioneve shqiptare klasifikohen si vijon:

1. Shërbimet me konkurrencë të kufizuar, në të cilat përfshihen shërbimet e

telekomunikacioneve, që mund të ofrohen në një zonë të caktuar gjeografike ose në gjithë vendin nga një numër i kufizuar operatorësh. Këto shërbime janë shërbimet bazë të telekomunikacioneve të mbështetura në rrjetin fiks dhe në atë të lëvizshëm.

2. Shërbimet me konkurrencë të lirë, në të cilat përfshihen shërbimet që ofrohen në një zonë të caktuar gjeografike, ose në mbarë vendin nga një numër i pakufizuar operatorësh. Këto shërbime janë: Ai i kërimit të personit (paging), transmetimi i të dhënave, shërbimet me vlerë të shtuar, televizioni i kablluar, grumbullimi dhe dhënia e informacioneve, shërbimet e telekomunikacioneve rurale, teleksi me shpejtësi të mëdha (teleteksi), komercializimi i pajisjeve të telekomunikacioneve, rrjetet e pavarura të telekomunikacioneve, ndërtimet dhe montimet e rrjeteve dhe pajisjeve të telekomunikacioneve, hartimi i projekteve, prodhimi i pajisjeve e materialeve të telekomunikacioneve etj.”

Neni 5

Neni 3.6 pika 1 ndryshohet si vijon:

“Parimet e vendosjes së tarifave për shërbimet e telekomunikacioneve me konkurrencë të kufizuar përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, kurse procedurat e vendosjes së tyre përcaktohen nga ERT.”

Neni 6

Neni 4.16 ndryshohet si vijon:

“Në rast se operatori, për shkaqe objektive, nuk është në gjendje të sigurojë shërbimin, ky i fundit mund të ndërpritet përkohësisht. Në këtë rast kontrata përkatëse pezullohet dhe pajtimtari lirohet nga detyrimi për të paguar tarifën e pajtimit për kohën e pezullimit.”

Neni 7

Në nenet 4.3 dhe 6.5, “DSHPT” zëvendësohet me “DPPT”.

Në nenet 6.13, 7.1, pika 2 dhe 4, si dhe te neni 7.2 “DSHPT” zëvendësohet me “ERT”.

Në nenin 6.13 “DSHPT” zëvendësohet me “Republika e Shqipërisë”.

Neni 8

Kreu V “Për licencat e operatorëve të telekomunikacioneve” shfuqizohet.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2005, datë 3.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani